



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Kuvendi i Kryeqytetit –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Arsim, mbajtur më 15.11.2022,
duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Dervishi, Berna Saraçi, Ajet Brajshori, Lindita Rexhepi.
Në mbledhje morën pjesë edhe: Besianë Musmurati, drejtore e DKA-së, Lulzim Vrapca,
zyrtarë nga DKA-ja.

Mungoi: Gjylbehare Llapi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Fatmir Dervishi, kryesues i komitetit me këtë

R E N D T Ë D I T Ë S

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së par të Komitetit për Arsim;
2. Gjendja në shkolla të komunës së Prishtinës pas përfundimit të grevës;
3. Procesi i përzgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve;
4. Plani për aktivitete të nxënësve për vitin 2022/23 (olimpiada, gara dhe aktivitete të tjera);
5. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Arsim

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Arsim.

Pika e dytë

Gjendja në shkolla të komunës së Prishtinës pas përfundimit të grevës

Besianë Musmurati, drejtore tha se duke mos u vonuar edhe shumë për pikën e dytë gjendja e shkollave pas grevës, mësimi ka vazhduar sikur çdo herë pas grevës d.m.th veç data 1 shtator

është vendosur me 1 tetor që ja vlen të theksohen dhe duhet të e dini ju si anëtarë që mësimi i të shtunave nuk është duke u zëvendësuar fare. Ka 2-3 shkolla që mbajnë ka 2-3 klasa por edhe ato janë shumë pak që këtë problem e kanë krejt Kosova e jo vetëm ne si Prishtinë, tash një informatë që ndoshta mundë të ndajë me ju, që prej javës së kaluar jam kryesuese e kolegjiumit të DKA-ve, në nivel të Kosovës. Kështu që do të kërkojmë takim me Ministren po besoj javën e ardhshme që të flasim pak për punën e zëvendësimit të shtunave sepse mësimi nuk po mbahet dhe nuk e dimë kur dhe qysh do të zëvendësohen ato ditë.

Ne si Komunë çka mund të ofrojmë si mbështetje që ata të bëjnë gjatë ditëve ashtu siç është kërkesa e prindërve se këtu problemi është se po dalin krejt arsimtarët, krejt drejtorët e shkollave por nuk ka nxënës kështu që ky është një problem i madhe.

Ajo në vazhdim tha se edhe në Kuvend do ta bëjë njoftimin për përgatitjet për vitin e ri shkollor se na u shty për shkak të grevës në seancën e ardhshme e kam edhe raportimin për përmbylljen e vitit të kaluar dhe çka kemi bërë ne për fillim të vitit, a keni ndonjë pyetje specifike për temën por gjendja është kjo.

Fatmir Dervishi, duke u ndërlidhur në diskutimin e znj. Musmurati tha se është mirë këtë çështje me e ngritë në nivel të Ministrisë dhe po besoj që duhet ta kuptojmë ne si asamblistë që të shtunën nuk mbahet mësim përveç që nuk po mbajmë mësim, ne si mësues a e din që është maltretim zgjohu shko në shkollë mësimi po mbahet nuk po mbahet, fëmijët ejani mos ejani është njëfarë çakordimi. Kështu që të gjejmë një zgjedhje në fund të vitit të mbajmë dy javë mësim, ne kemi humbur mësim edhe më shumë katër javë.

Lulzim Vrapca, tha se gjendjen në shkollat tona pas grevës e kemi ditur mirë çfarë është, zëvendësimi është e vërtet që nuk është bërë në asnjë shkollë duke e përjashtuar 1% ndoshta 2%, në krejt shkollat nuk del diku një nxënës, diku dy e diku ndoshta një klase. Kisha dashur të shkarkohen njerëzit nga egoja e vet, sepse arsimi është interes nacional nuk është interes individual dhe ta merr një vendim shumë urgjent kur e ka parë javën e parë dhe javën e dytë kur vet prindërit kanë deklaruar se ne nuk i sjellim fëmijët në shkollë.

Ai në vazhdim tha se vet deklarata e prindërve është dashur urgjentisht të ulen organet përgjegjëse të arsimit dhe të gjejnë zëvendësim në kushte normale e them nga përvoja nuk e jep efektin e duhur. Ai mes tjerash tha se kjo qe ka ndodhur ne shkollat tona në nivel vendi se nuk ka ndodhur kjo vetëm në Prishtinë mos ta marrim vetëm ne është problem institucional dhe ne do te dalim por nga kjo situatë. Më të pafajshmit janë fëmijët të gjithë e kemi thënë dhe e themi përsëri por edhe në anën tjetër edhe mësimdhënësit besoj kërkesat e tyre kanë qenë të arsyeshme që duhet ti arsyetojmë me grevën qe e kanë pasur, sepse ata tash po i bie nëse zëvendësohen edhe njëherë te dalin dy dite për të njëjtën ditë.

Ai në vazhdim e sipër tha se presim një konfirmim me profesional për këtë çështje nuk është e pa ndjeshme por shumë e ndjeshme, por të gjejmë një modalitet i cili është më i pranishëm, më i arsyeshëm, për mos me e dëmtuar procesin mësimor me shumë për ketë vit duke uruar që janari të mos na hedhë prapë në grevë.

Besianë Musmurati, drejtore tha se unë jam shume ihtarë me këto deklaratat e mëdha por asgjë në dorë nuk kemi, ne mundë të flasim, por në fund e vendos Ministria, çka na takon neve si Komuna ne po e bëjmë kërkesën, mirépo ai është vendim i Ministrisë.

Ajo në vazhdim tha se sa i përket Komunës se Prishtinës, i kemi ofruar të gjitha kushtet e mundshme që mësimi të zëvendësohet të shtunave.

Ajo mes tjerash tha se ka anomali shumë të mëdha kështu qe po e them prape janë obligime të cilat nuk janë tonat dhe mendojnë se çka na përket neve është me ofruar bashkëpunimin me të madh që e kemi ofruar si Komunë e Prishtinës.

Ne kemi propozuar që fillimisht ti shtojmë disa orë brenda ditës qe me u zgjatë orari edhe e kemi propozuar një pjesë në fund te vtitit shkollore e një pjesë në mes vtitit shkollor që me hekë komplet pushimin pranveror.

Pika e tretë

Procesi i përzgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve

Besianë Musmurati, drejtore sa i përket procesit të përzgjedhjes së drejtoreve dhe zëvendës drejtoreve, tha se orari i konkurseve është tash i hapur dhe me të përfunduar mblidhet komisioni dhe i shqyrton ato kush i plotëson kushtet e kush jo dhe kemi procesin e intervistave.

Në qoftë se jeni të pajtimit ju mundë të vini unë e kam shtuar Komitetin për Arsim, si pjesë të listës së vëzhguesve, ne ju njoftojmë si t'i bëjmë ato listat e ngushta që janë dhe datat kur mbahen intervistat për secilën shkollë dhe ju ftojmë në qoftë se jeni të interesuar, kisha pasur dëshirë që të jeni edhe ju prezent gjatë intervistave.

Ajo po ashtu ceku se në ueb faqe të Komunës është udhëzuesi që e kemi publikuar për vëzhgues mund ta lexoni aty ta shihni se cilat janë përgjegjësítë që ta shihni pak a shumë gjatë procesit të intervistave. Gjithashtu prezent do të jenë edhe Kallxo.com, GLPS dhe Ambasadën Britanike.

Berna Saracı, tha se kisha pasur dëshirë të marr pjesë po mendoj e analizoj pastaj qysh janë por të paktën me e pa si procese ajo është me rëndësi në fakt.

Fatmir Dervishi, tha se do të ishte mirë me i parë ato dokumente, me i përpunuar mirë komisioni edhe në raport me plotësimin e kritereve të konkursit dhe dokumentacioneve me qenë në mënyrë që ne kur është i pari, dyti, terti, katërti ose i pesti, brenda ditës të kemi mundësi të i përcjellim.

Besianë Musmurati, drejtore tha se ju kisha rekomanduar kush do që të jetë pjesë e procesit të lexoj udhëzimin administrativ, si dhe konkursin.

Ajo në vazhdim tha se komisioni që është votuar në asamble është një anëtarë i DKA-së, kryesuese është Arbena, është një anëtarë ekspert i jashtëm dhe një anëtarë prej Ministrisë. Të Ministrisë janë 4 që ndërrohen të ndryshëm p.sh për çerdhe është dikush tjetër, për shkolla profesionale tjetër, për secilin. Arbena është në krejt komisionet është e vetmja që është në të gjitha komisionet dhe 2 ekspertët e jashtëm edhe ata ndërrohen njëherë është Egzoni pastaj është Jehona.

Lindita Rexhepi, shtroi pyetje se a është obligative d.m.th të marrim pjesë ne si vëzhgues.

Besianë Musmurati, drejtore tha se jo vetëm që unë kam pasur dëshirë që ju me qenë aty edhe ju kam futur në listën e personave që minden me qenë aty gjatë gjithë procesit, e ju pastaj si të doni mindenit të kombinoheni mes vete por unë kisha pasur dëshirë që gjithqysh dikush prej jush të

jetë aty gjatë gjithë kohës, sepse ka shumë pozita, e kuptoj që edhe ju keni punë, por nëse mundeni një ditë të ja kushtoni kësaj pune.

Ajo mes tjerash tha se një javë përpara do ti merrni informatat kur janë intervistat dhe vendin dhe orën e mbajtjes së tyre.

Lindita Rexhepi, shtroi pyetje se a do të përfshihen të gjitha shkollat d.m.th në këtë proces.

Besianë Musmurati, drejtore tha se po kësaj here në konkursin e parë i kemi 6 shkolla, në procesin e dytë që do të fillojë këtë javë, do t'i kemi besoj deri 9 shkolla fillore, që do të fillojnë, por jemi duke e bërë me fazë-faza për shkak që është e pamundur brenda 45 ditëve të kryhen procedurat si e thotë udhëzimi administrativë.

Ajet Brajshori, shtroi pyetje se a ka ndonjë vendim nga Gjykata Themelore e Prishtinës lidhur me shkeljen e ligjshmërisë për përzgjedhjen e drejtorëve.

Besianë Musmurati, drejtore tha se ka vendim Gjykata Themelore e Prishtinës, po ajo ka qenë për Inspektoratin e Arsimit për kallëzimet penale, që i kanë bërë për individ jo për procesin d.m.th për shkak që nuk është zbatuar vendimi i inspektoratit. Inspektorati ju ka bërë padi Shpend Ahmetit, Avni Zukës dhe Shpresës, tash po besoj gjykata në kohë të ndryshme do t'i shqyrtoj Shpresa e ka marr vendimin si e pafajshëm për shkak se Shpresa si Drejtori e Arsimit, nuk ka qenë pjesë e proceseve.

Ajet Brajshori, tha se unë e bëra këtë pyetje sepse e kemi edhe vendimin e Gjykatës Themelore, fuqizon edhe vendimin e inspektoratit, se shumë janë thirrur në këtë çështje.

Besianë Musmurati, drejtore tha se vendimi i inspektoratit është i detyrueshëm për Komunën çka do që vendos gjykata, Gjykata me ta kthyer në fund krejt me dal kundër inspektoratit që nuk ndodh kurrë por qe po del krejt kundër, atëherë asgjë mos të ndodhë të anulohet konkursi më e keqja që mund të ndodh.

Pika e katërt

Plani për aktivitete të nxënësve për vitin 2022/23 (olimpiada, gara, aktivitete tjera)

Fatmir Dervishi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se më të vërtetë shkollat janë bërë pak si jo atraktive, në mungesë të aktivitetave të brendshme. Nuk e dijë që në Prishtinë a ka dikush aktivitet jashtë shkollës a jo, shkollë me shkollë, shkollat me lagje, kështu që kamë menduar me e bërë një plan, tash e kemi olimpiadë të shtunën kemi marrë informatë ka ma shumë se tri javë.

Kështu që kamë menduar me i vendosë në listë me i bërë në fillim të vitit shkollor në dy shkolla, gara mbahet me këtë datë përafërsisht, edhe ku mendoj që duhet me pasur një kalendar. Kemi pasur shumë ankesa se nuk munden me i bërë gati për dy javë për një olimpiadë, duhet 6 muaj ndoshta për me e bërë një fëmijë të gatshëm.

Ai në vazhdim tha se kemi fëmijë që janë super të mirë por dështojnë në olimpiadë, ndihet keq ai, prindi, familja ajo është olimpiadë është e rëndë është kampionat botëror në një farë forme në nivel vendi është, një kalender besoj që e bëjmë shumë të mirë edhe kam menduar që ne së bashku me ju

me drejtor kishim mundur me e gjete një garë një aktivitet që mbahet ndoshta edhe jashtë shkollës, a mbahet në Gërmë apo në oborr të shkollës, ndoshta një ditë në "Dardani", një ditë në "Emin Durak", por me e bërë si kalendar është mirë, këto janë specifikat për secilin aktivitet ose garë.

Besianë Musmurati, drejtore tha se ne e kemi bërë një listë kalendarike, ndoshta kishim mundur me e ndarë me komitetin, se e kemi bërë një listë të datave me rëndësi, që mendojmë se shkolla duhet me i shënuar, si Dita e tokës, etj. Për pos këtyre aktiviteteve, olimpiadave, ka edhe ditë me rëndësi që mendojmë që mundemi me i shënuar në kalendar p.sh dita e shëndetit mendor e shumë aktivitete tjera.

Fatmir Dervishi, tha se po i bëjmë këto aktivitete brenda shkollës, por kështu po mendoj me i zgjeruar më shumë. Ai në vazhdim tha se e bëjmë një llogari ne i kemi 40 shkolla përafërsisht, veç nga 10 nxënës me u aktivizuar bëjnë 400, ku minimumi 100 i ke të aktivizuar për gjuhë shqipe, matematikë, biologji, kimi edhe nuk kanë kosto të lartë, me i llogarit vendin e parë, i dytë i tretë, nëse pajtohen mësueset me e shpërblyer me pare apo mirënjojje edhe pse unë jam adhurues i pareve si shpërblim, përveç mirënjojjes, nuk kanë kosto shumë të madhe.

Besianë Musmurati, drejtore tha se kisha pasur dëshirë që vitin e ardhshëm me filluar një lloj subvencionimi, përfmijët të cilët kanë arritje të mira në gara komunale. Si Komunë kishim mundur që të ju japim nga 50 euro dhe ti shpërblejmë ata të cilët e fitojnë garën.

Berna Saraci, lidhur me çështjen e bursave tha se këto shpërblimet që janë veç pare me thënë, janë mirë por në të njëjtën kohë janë sikur e bëre një punë e more një shpërblim edhe u krye, por duhet shikuar mundësinë që ata nxënës të shpërblehen dhe në forma të tjera.

Besianë Musmurati, drejtore tha se unë e kam menduar dhe e kemi një eko klube me Caritasin që jena duke e bërë një far projekti, kush do që fiton merr buxhet shkolla, kjo vlen vetëm për shkollat e mesme.

Ajo në vazhdim tha se projekti me i mirë i fiton 5 mijë euro buxhet për shkollën dhe tani me realizuar atë projekt brenda shkollës.

Mes tjerash ajo tha se ne mundemi me bërë edhe diçka të tillë që ndoshta si merr fëmija direkt po i merr shkolla në formë të investimit, nëse për shembull për gara të diturisë me e bërë një aktivitet, që me ja financuar shkollës një aktivitet, një shëtitje të fëmijëve diçka që lidhet me matematikë ose që lidhet me një muze, mundemi me qenë super kreativ në këtë aspekt, kjo ma e lehta është me u dhënë nga 50 euro, që nuk është gjë e keq se i motivon me shumë fëmijët.

Ajet Brajshori, tha se unë mendoj pak me ndryshe, mendoj me e bërë ma atraktive, me i ndarë ato për rrëth organizimit të kampanjave të ndryshme, një pjesë që e thatë edhe ju drejtore, po e flas nga përvoja. Gara në njëren prej fushave ose projektet për rregullimin e ambientit, ose projekte të ndryshme që kemi pasur mbështetje prej organizatave të huaja kanë shkuar fëmijët me nga 10 ditë jashtë me gara të ndryshme. Ky është një motiv që ne këtë shkollë 5 nxënës u zgjodhën më të mirët por të garojnë me 5 nxënës bashkëmoshatar të tyre në shtete jashtë, ky është një motiv shtesë që unë kam pas fat në Rakovicë, 11 nxënës kanë qëndruar 10 ditë në Hungari pse e kanë fituar projektin "Ambienti më i mirë në shkollën time", shembull në këtë mënyrë por kjo nuk bëhet për një ditë, ne

duhet ta bëjmë planin operativ prej fillimit prej drejtorit dhe gjithë personelin bashkë me nxënësit dhe gjithë komunitetin e prindërve për me pasur sukses.

Besianë Musmurati, drejtore tha se për mua është me rëndësi dhe ju i keni resurset kryesore për me e bërë, prof. ju keni qenë drejtor shkolle, d.m.th e dini brenda shkollës me ken duhet me fol çka duhet me fol, Berna ti je pedagoge ke punuar në shkollë, i kemi krejt kapacitet brenda, me dizajnuar diçka të mirë, uluni dizajnoni, koston edhe ne tani si Drejtori e Arsimit, mundemi me shikuar brenda atyre subvencioneve që i kemi të planifikuara, buxhetin tash veç e kemi aprovuar për vitin tjetër, por a kishim mundur përmes asaj vijës buxhetore të dedikuara për studentë, me ul numrin e bursave, mos me i jep 120 bursa kot, ato janë pare kot.

Fatmir Dervishi, tha se ne po kemi problem me olimpiada shumë përmes shoqatave, ai i bon detyrat krejt, detyrat janë jashtëzakonisht të rënda janë shumë të renda, jemi ankuar qe 2-3 vjet, e kanë lehtësuar pak kriterin e tash u dal pak ma mirë. Ka qene një format me 5 detyra, 20 pikë edhe kanë qenë detyra të tmerrshme, kështu që pak i kemi zbeh raportet me ta, por prapë nuk jemi mirë.

Berna Saraci, tha se duke kërkuar një material për vete dhe pash diçka shumë të mirë, përmes programit Erasmus plus, nuk e di a e keni parë, është program vetëm për trajnime, jo me studiuar jo master, janë trajnime të shkurta me javë nuk e di saktë po varet cilin drejtim e donë, kishte me dhjetëra trajnime, këtu duhet ne nivel institucional me shkuan. Krejt janë të paguara çka duhet me bërë është me aplikuar Komuna, ose e gjej linkun.

Pika e pestë Të ndryshme

Fatmir Dervishi, ju drejtua drejtores së arsimit tha se unë dua të marr një mendim drejtore, a kishim mundur ne me marre një vendim për çështjen e telefonave në shkollë, se shumë probleme që po na ndodhin janë kur po e nxjerrim burimin po del të jetë telefoni.

Lulzim Vrapca, tha se ne ju kemi dërguar shkollave edhe në takime me drejtor, e kanë potencuar këtë çështje absolut ta zgjedhim në mënyrën më të mirë të mundshme, tash ka pasur drejtor që kanë thënë qysh me ja bërë a me i marr ata telefona, thash ju jeni drejtor edhe ju duhet me e gjet një zgjidhje.

Ajet Brajshori, tha se na si drejtor i kemi dërguar shkresa i kemi ftuar dy herë në takime, dalim nuk zbatohet kjo, drejtori është përgjegjës për këtë punë, se nuk është duke e zbatuar së pari një udhëzim administrativ, e dyta udhëzimet e drejtorisë.

Me fillim të vitit shkollor ne i kemi marrë masat, në takimin e fillimit të tectorit unë realisht në takim e kam përmend këtë pjesë edhe shkresë ju kemi dërguar krejt drejtorëve të shkollave, që kjo pjesë duhet me u zgjedhë se nuk është normale, e tmerrshme është kjo punë.

Besianë Musmurati, drejtore tha se e lehtë është qysh nuk është e lehtë, drejtori e ka një sirtar, në momentin qe kur i sheh fëmijës telefonin në dorë ja merr edhe e vendos në sirtar, tri herë kështu,

përveç nëse ka ndonjë arsyё madhore se mundet me pas arsyё, po udhëzimi administrativ këtu është tepër i qartë se çka duhet me u bërë e çka nuk duhet me u bërë.

Ajo në vazhdim tha se sa na përket neve si DKA, ne nuk po kemi kapacitete me u bërë polic nëpër krejt shkollat e Prishtinës, me ja nis na me këqyrë kush po man telefon d.m.th na veç duhet me e mbyllur DKA-në, pasi që kemi mungesë të stafit, ne veç jemi duke punuar që me e zgjeruar stafin brenda DKA-së.


Ajet Brajshori, tha se ndoshta ma të mirën nuk mundemi me e bërë, por le të organizohen organizmat brenda, të fillojmë nga personeli, kujdestari i klasës, këshilli, aktiv profesional. Analizën e situatës në kuadër të javës, problemet munden me u zgjedh, nuk po ja adresoj vetit por edhe ne kemi kaluar nëpër ato ujëra, e dimë mirë, t'i përcakton udhëzimi administrativ, kujdestari i klasës atje ku është aktiv, kur nuk ki me pas probleme me telefona, nxënësit i mbajnë po nuk i përdorin, ndodhin pikërisht në ato klasë ku nuk është aktiv kujdestari i klasës, po e them hapur se kështu ndodh.

Këto nëse janë të fuqizuara dhe e kryejnë punën e vet për çka janë të thirrur, nuk po them që e bëjnë punën më të mirë të mundshme, por me amortizuar e amortizojnë.

Fatmir Dervishi, kryesuese tha se nëse nuk keni me shtuar diçka, e deklaroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja mbaroi në orën 17:50

Procesmbajtësja
Lendita Spahija



Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Dervishi